

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-098/14

Prishtinë, 30 mars 2016

Në çështjen juridike të:

B. V.

Prishtinë

Pala ankuese

kundër

V. (B.) M.

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, si kryetar i kolegjit, gjyqtarët Rolandus Bruin dhe Krassimir Mazgalov anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK-së) KPCC/D/A/219/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA25058), të datës 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 30 mars 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga B. V. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/219/2013, të datës 27 nëntor 2013, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/219/2013 i datës 27 nëntor 2013, vërtetohet në lidhje me kërkesën KPA25058.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 12 shkurt 2007, V. (B.) M. (tani e tutje, “pala përgjegjëse në ankesë”) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP-së), me të cilën ka kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore dhe ri-posedimin e ngastrës nr. 424/2 me sipërfaqe prej 00.02.75 ha, e cila gjendet në vendin e quajtur “Seliste Susnjak”, në fshatin Prugoc, Komuna e Prishtinës (tani e tutje: “prona e kërkuar”). Prona është regjistruar në AKP me numër KPA25058.
2. Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se ka humbur posedimin e pronës së kërkuar më 19 qershor 1999 për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë më 1998/1999.
3. Në mbështetje të kërkesës, pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur dokumentet në vijim:
 - Kopjen e fletës poseduese nr. 227 të datës 18 qershor 1996, në të cilën pala përgjegjëse në ankesë figuron si pronar i pronës së kërkuar;
 - Vendimin nga shërbimi i kadastrit dhe pronës së paluajtshme në Prishtinë Nr. 952-01-1/96-190-c të datës 25 prill 1996 (tani e tutje, “vendimi i 25 prillit 1996”). Kadastrit ka lejuar – për aq sa është relevante – ndryshimin e emrit të shfrytëzuesit të ngastrës kadastrale nr. 424/2, e cila deri atëherë ka qenë e regjistruar në fletën poseduese nr. 12 në emër të ZZ Nëntë Jugoviqët në emër të palës përgjegjëse në ankesë.
4. Më 11 shtator 2007 dhe 14 maj 2013, AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës duke vendosur lajmërimin mbi në pronën e kërkuar. Gjatë njoftimit të parë, është vërejtur se prona e kërkuar ka qenë pjesërisht e kultivuar nga persona të panjohur, dhe gjatë njoftimit të dytë

prona e kërkuar nuk ka qenë e uzurpuar. Më 18 shkurt 2010, dhe më 15 maj 2013, AKP-ja ka konfirmuar saktësinë e njoftimeve të mëparshme të pronës së kërkuar.

5. Më 19 shkurt 2007, B.V. pretendon se ka të drejta ligjore mbi pronën e kërkuar. Sidoqoftë, më 5 qershor 2010, ai ka pohuar se nuk i ka kërkuar të drejtat ligjore mbi pronën e kërkuar. Më 20 mars 2014, AKP-ja ka tentuar që t'ia dorëzojë B. V. vendimin e KKPK-së, i cili tani e tutje përmendet në paragrafin 8, sidoqoftë, ai nuk e ka pranuar vendimin e KKPK-së dhe ka konfirmuar se nuk ka asgjë të bëjë me pronën e kërkuar. Për këtë arsye, Gjykata Supreme nuk e identifikon B.V. më tutje si palë në këtë procedurë.
6. Më 18 qershor 2013, B. V.(tani e tutje: “pala ankuese”) ka nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes duke pretenduar të drejta ligjore mbi pronën e kërkuar. Para kësaj, ai gjithashtu është përgjigjur ndaj kërkesës së palës përgjegjëse në ankesë lidhur me një pronën tjetër në afërsi me numër të kërkesës KPA25056. Pala ankuese thekson se prona e kërkuar i takon kushëririt të tij E. V. i cili aktualisht jeton jashtë vendit. Më tutje, pala ankuese pohon se prona e kërkuar si dhe prona e kërkuar në kërkesën KPA25056 i ka takuar familjes V. deri në shpronësim rreth viteve 1945-50. Në mesh tjerash, së bashku me përgjigjen e tij në të dy lëndët ai ka paraqitur dokumentet në vijim:
 - Vendimin mbi konfiskim KFC Nr. 91/45;
 - Vendimin mbi konfiskim nr. 15744 të datës 13.12.1943;
 - Skicën në dorëshkrim;
 - Vendimin mbi ndarjen e parcelave të konfiskuara nga Kooperativa Bujqësore Nëntë Jugoviçët.

AKP-ja ka shtuar këto dokumente në shkresat e lëndës në lëndën nr. KPA25056.

7. Më 19 tetor 2007, AKP ka verifikuar pozitivisht fletën poseduese nr. 227 të dorëzuar nga pala përgjegjëse në ankesë. Dokumenti është verifikuar pranë Departamentit të Kadastrit më 18 tetor 2007; një kopje e fletës poseduese nr. 227, të datës 18 tetor 2007, i është bashkangjitur raportit të verifikimit. Më 16 korrik 2013, AKP-ja ka konfirmuar se ngastra nr. 424/2 është e regjistruar në regjistrin kadastral në emër të palës përgjegjëse në ankesë, dhe sipas detyrës zyrtare e ka futur në dosje certifikatën nr. 011-095-112236, të datës 15 korrik 2013 nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, që e konfirmon këtë regjistrim. AKP-ja gjithashtu e ka verifikuar pozitivisht vendimin e 25 prillit 1996. AKP-ja nuk i ka verifikuar dokumentet e dorëzuara nga pala ankuese, pasi që AKP-ja ka konstatuar se asnjëri nga këto dokumente nuk ka të bëjë me pronën e kërkuar.

8. Më 27 nëntor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje: KKPK) në vendimin e tij grupor KPCC/D/A/219/2013 ka pranuar kërkesën. Në arsyetimin e vendimit (paragrafët 11 dhe 29 deri në 31), KKPK-ja ka theksuar se pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar fletën poseduese nga viti 1996 në të cilën identifikohet si pronar i pronës së kërkuar. Më tutje, KKPK-ja ka marrë parasysh deklaratën e palës ankuese se prona e kërkuar i takon kushëririt të tij E. V. KKPK-ja ka vërejtur se pala ankuese ka dorëzuar disa dokumente nga vitet 1940-ta për të mbështetur pretendimin e tij se prona e kërkuar i ka takuar familjes së tij mirëpo asnjëri nga këto dokumente nuk përmendte pronën e kërkuar. KKPK-ja ka pranuar kërkesës në bazë të provave të paraqitura nga pala përgjegjëse në ankesë dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala ankuese.
9. Më 20 mars 2014, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 2 prill 2014. Në ankesë, pala ankuese i referohet dokumenteve të dorëzuara në KPA të cilat janë përmendur në paragrafin 6.
10. Më 14 prill 2014, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë. Më 27 maj 2014, AKP-ja palës përgjegjëse në ankesë ia ka dërguar ankesën përmes postës. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.
11. Më 5 shkurt 2016, Gjykata Supreme ka dërguar një urdhër të gjykatës në KPA. Gjykata Supreme ka kërkuar nga AKP-ja që t'i dorëzoj dokumentet e referuara nga pala ankuese në shkallën e ankesës pasi që ato ishin dorëzuar nga pala ankuese në shkallën e parë dhe janë vlerësuar nga KKPK-ja. Më 23 shkurt 2016, në përgjigje të urdhrit të gjykatës, AKP-ja ka dorëzuar dokumentet e kërkuara.

Pretendimet e palës ankuese:

12. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është bazuar në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe në zbatim të gabuar të ligjit material. Në mbështetje të pretendimit të tij, pala ankuese pohon se dokumentet në vijim mbështesin ankesën e tij:
 - Vendimi mbi konfiskimin KFC. Nr. 91/45;
 - Vendimi mbi konfiskimin nr. 15744 i datës 13.12.1943;
 - Skicën në dorëshkrim të dorëzuar në AKP më 01.12.09;

- Vendimin mbi ndarjen e parcelave të konfiskuara nga Kooperativa Bujqësore Nëntë Jugoviçët.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

13. Ankesa është paraqitur brenda 30 ditëve siç është paraparë me nenin 12.1 të rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (tani e tutje: “Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50”). Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës

14. Pasi që pala ankuese në ankesën e tij kundërshton vendimin e KKPK-së me të cilin vërtetohet pronësia e palës përgjegjës në ankesë mbi pronën e kërkuar, Gjykata Supreme do të adresoj dy çështje kryesore: nëse vlerësimi i KKPK-së i pretendimeve të palës përgjegjëse në ankesë lidhur me pronësinë e tij janë të sakta, dhe nëse ankesa e palës ankuese kundër vendimit të KKPK-së ka bazë të vlefshme.
15. Përkitazi me këtë, Gjykata Supreme së pari thekson se KKPK-ja ka konstatuar drejtë se fleta poseduese nr. 227 e verifikuar pozitivisht e cila është dorëzuar nga pala përgjegjëse në ankesë, dhe sipas detyrës zyrtare ka futur në shkresat e lëndës certifikatën nga Agjencia Kadastrale e Kosovës janë të mjaftueshme për të vërtetuar pronësinë e palës përgjegjëse në ankesë mbi pronën e kërkuar.
16. Gjykata Supreme më tutje vëren se në shkallën e parë, pala ankuese ka deklaruar se ai kishte pasur leje nga kushëriri i tij E. V. për ta shfrytëzuar pronën. Ai ka shtuar se nuk ka pasur njohuri nëse kushëriri i tij ka pasur ndonjë dokument për pronën. Pala ankuese ka dorëzuar dy vendime mbi konfiskimin të datës 14 dhjetor 1945 dhe 13 dhjetor 1943, në të cilat tregohet se prona e I. B. është konfiskuar; dhe vendimin e datës 28 prill 1954 mbi ndarjen e pronës Kooperativës Nëntë Jugoviçët.

17. Dokumentet e dorëzuar kanë të bëjnë me konfiskimin e pronës dhe rindarjen tek pronarët tjerë. Në mënyrë më specifike, vendimi mbi konfiskimin i datës 14 dhjetor 1945 vendos për konfiskimin e *“arës në kufi dhe e matur nga veriu i përroit Lebanski 50 m dhe nga ana jugore e pronës së R. H. 95 metra, nga lindja e pronës së A. I. 60 metra dhe nga ana perëndimore e pronës së J.B. 164 metra”* e cila i takon I. B.. Më tutje, vendimi mbi konfiskimin i datës 13 dhjetor 1943 thekson se prona e I. B. konfiskohet pa ndonjë detaj të mëtutjeshëm. Përfundimisht, vendimi i datës 28 prill 1954 mbi ndarjen e pronës Kooperativës Nëntë Jugoviqët rendit 33 ngastra dhe tregon personin të cilit i rindahet prona.
18. Gjykata Supreme vëren se në asnjërin nga dokumentet e dorëzuara nuk përmendet prona e cila do të mund të korrespondonte me pronën e kërkuar. Pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër e cila do të ndihmonte në identifikimin e pronës së përmendur në vendimet mbi konfiskimin dhe për të përcaktuar nëse prona e kërkuar është përmendur në vendimet mbi konfiskimin. Në dritën e kësaj, Gjykata Supreme nuk është në gjendje që përcaktojë nëse dokumentet e dorëzuara nga pala ankuese kanë të bëjnë me pronën e kërkuar. Për këtë arsye, provat e dorëzuara nga pala ankuese nuk mund ta mbështesin pretendimin e tij se pala përgjegjëse në ankesë nuk është pronar i pronës së kërkuar.
19. Rrjedhimisht, KKKPK-ja me të drejtë ka vendosur se pala përgjegjëse në ankesë është pronar i pronës së kërkuar, dhe ankesa refuzohet si e pabazuar kurse vendimi i KKKPK-së vërtetohet në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

Këshillë juridike:

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike

Beshir Islami, Kryetar i kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it